



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 280, Datë 06.11.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 171, Datë 31.07.2025
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 30 MW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2778 prot., datë 04.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 MW”,

Konstatohet se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k.

- Me vendimin e ERE nr. 171, datë 31.07.2025, shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 MW, për një afat 30-vjeçar.
- Në kuptim të sa përcaktuar në pikën 2 të vendimit shoqëria përpara fillimit të operimit, duhet të depozitohet në ERE marrëveshjen e nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., për miratimin e pikës së lidhjes së centralit fotovoltaik me rrjetin e transmetimit.

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- Shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1841/9 prot., datë 22.10.2025, ka depozituar kopjen e njehsuar me origjinalin të marrëveshjes për lidhjen me rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik EZ-5 Solar 2, nënshkruar mes shoqërisë “OST” sh.a. dhe “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., me nr. 677/10 Prot., datë 20.10.2025 dhe ka kërkuar rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 171, datë 31.07.2025, në kuadër të plotësimit të kushteve të përcaktuara në vendim.
- Nga raportimi periodik i OST sh.a. për muajin shtator 2025, rezulton se ky central nuk ka filluar ende prodhimin e energjisë elektrike.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Në përputhje me pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025, dhe me depozitimin nga shoqëria të marrëveshjes së nënshkruar me “OST” sh.a., rezulton se ky kusht është i përmbushur.
- Për pasojë, pika 2 e dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025, vlerësohet të shfuqizohet.

- Gjithashtu, pika 5 e këtij vendimi, e cila përcakton se vendimi është objekt rishikimi në rast të plotësimit ose mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3 dhe 4, vlerësohet të ndryshohet për të reflektuar faktin që pika 2 është tashmë e përmbushur.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 e dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025, duhet të shfuqizohet, pasi shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. ka përmbushur kushtin përkatës dhe duhet të reflektohet situata aktuale e realizimit të projektit.
- Gjithashtu, pika 5 e vendimit nr. 171/2025 përcakton se: *Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2,3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.*
- Në kuadër të plotësimit të pikës 2 vlerësohet të bëhet: *Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025, shfuqizohet.
2. Pika 5 e vendimit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025, ndryshohet si vijon: *“Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi”.*
3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI